



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odejenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 2873 Më. 04.09.2024
Br. prot. Dt. 04.09.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
623-24-3443-2-1-1/C611

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: NEWS SH.P.K.; N.SH. GEO-MAP, L. e Prizrenit, 143, ISTOG, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i Kontratës: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**

Me numër identifikues: **623-24-3443-2-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Digjitalizimi i Dokumentacionit Kadastral – Rirregullimi i Vektorit në Komunën e Rahovecit – Ritenderim**

<i>Nr.</i>	<i>Grupi</i>
1	DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë prej **36 Muajsh**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë...ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës për njësi është (*Çmimi i përgjithshëm i peshuar*): **1.09 Euro**. [Një Euro e nëntë Cent]

Vlera totale indikative e kontratës është: **295,000.00 Euro**. [Dyqind e nëntë dhjetë e pesë mijë Euro]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën: Shqipe¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:			
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Smajl Latifi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ / Kryetari i Komunës së Rahovecit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04.09.2024	Data:	04.09.2024
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve:	
Emri:	Fisnik Loshi
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	04.09.2024
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit. Ekzekutimi i urdhrimit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asetit të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

623-24-3443-2-1-1/C611

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është me datën e nënshkrimit të Kontratës.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është: Në territorin e Komunës së Rahovecit
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. b) Përgjegjësia e palës së tretë: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. d) Përgjegjësia profesionale: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve: 100 % përgjegjësi e Operatorit Ekonomik.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoriteti Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të Kërkesave për pagese do të bëhen për shërbimet e performuara.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i projektit i caktuar me vendim nga Zyrtar Kryesor Administrativ.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.



Komuna e Rahovecit

Opstina Rahovec

Municipality of Rahovec

PROJEKT – Specifikimet teknike

Titulli: Dixhitalizimi i të dhënave kadastrale në Komunën e Rahovecit

Rahovec, 2023

Përmbajtja

1. Qëllimi i projektit	3
2. Të dhëna të përgjithshme	3
3. Projekt idea	4
4. Objektivat e projektit.....	4
5. Realizimi i Projektit	5
5.1. Sistemi Koordinativ KosovaREF01	5
5.2. Rilevimi i pikave të rrjeteve gjeodezike (trigonometrike dhe poligonale) dhe trajtimi i gabimeve eventuale	5
5.3. Llogaritja e të gjitha pikave detale (kufijve të parcelave) pas identifikimit të gabimeve eventuale	6
5.4. Analizimi i planeve kadastrale të gjeoreferencuara	6
5.7. Transformimi i dokumentacionit tjetër dhe trajnimi i stafit.....	7
6. Të dhënat kadastrale.....	8
7. Të dhënat kadastrale digjitale – vështrim i përgjithshëm.....	10
8. Palët e interes	13
9. Analiza e asetëve financiare që burojnë nga dixhitalizimi i të dhënave kadastrale	13

1. Qëllimi i projektit

Ky projekt është paraparë që të zhvillohet në 4 faza/drejtime kryesore dhe ka qëllim primar që informacioni kadastral të jetë më lehtë i çashëm dhe i shfrytëzueshëm për palët e interesit. Fushat në të cilat do të shtrihen aktivitetet për implementimin e këtij projekti janë si më poshtë:


1. Llogaritja e koordinatave të pikave detaje nga fletoret takeometrike
2. Analiza e rrjetës dhe identifikimi i gabimeve eventuale sipas Kornizës së punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale(2020/01);
3. Trajtimi i gabimeve të transformimit të të dhënave sipas Kornizës së punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale(2020/01);
4. Alokimi i të dhënave (Dorëzimi në AKK pas përfundimit)

2. Të dhëna të përgjithshme

Rahoveci është qytet dhe komunë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në veri kufizohet me Klinën, në lindje me Suharekën, në pjesën jugore gjendet komuna e Prizrenit, ndërsa në tërë pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Gjakovës. Përafërsisht ka diku 276 km².

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.

Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione e këto janë: rafshirë-luginore, kodrinore dhe malore.



Pozita e Komunës së Komunës së Rahovecit

Regjistrimi i vitit 2011 tregoi se komuna e Rahovecit kishte një popullsi prej 56.208, prej të cilëve 55,166 ishin shqiptarë, 404 ashkali, 299 egjiptianë të Ballkanit, 134 serbë, 10 boshnjakë dhe 2 turq.

3. Projekt idea

Komuna e Rahovecit dhe organet e saj qeverisëse po adresojnë nevojën për informacion kadastral në një format të modernizuar dhe të sigurt. Kjo nismë synon të rrisë aksesin dhe sigurinë e të dhënave, duke kontribuar përfundimisht në mbrojtjen e të dhënave.

Projekti do të përfshijë mbledhjen, analizën dhe përpunimin e të dhënave kadastrale për të siguruar disponueshmërinë e tyre për palët e interesuara. Përmes përdorimit të platformave të përshtatura për nevojat e Rahovecit, projekti synon të ofrojë qasje të shpejtë në informacione të sakta për autoritetet komunale, banorët dhe palët e tjera të interesuara.

Duke përmirësuar qasjen në të dhëna të besueshme, projekti synon të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Rahovecit, duke siguruar trajtim të drejtë dhe siguri në lidhje me pronat e tyre.

4. Objektivat e projektit

Disa nga objektivat primare të projektit në fjalë janë:

1. Llogaritja e koordinatave për të dhënat kadastrale dhe trajtimi i gabimeve të të dhënave sipas Kornizës së punës për matje, krijim dhe regjistrim të njësisve kadastrale
2. Qasje më e lehtë në të dhëna kadastrale nga zyrtarët komunal dhe gjeodetët e licencuar nga AKK
3. Zhvillimi ekonomik komunal dhe tërthorazi ndihma në zhvillimin ekonomik në nivel shtetëror,
4. Përbushja e objektivave strategjike zhvillimore në nivel komunal dhe nacional, sipas rekomandimeve nga AKK,
5. Ndihmesa në qendrueshmërinë ekonomike afatgjate dhe ndihmesa në ofrimin e shërbimeve sa më adekuate për qytetaret apo të tjerët që kërkojnë shërbime nga Komuna.
6. Në përgjithësi zhvillimi i një projekti të tillë ndihmon drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.
7. Mbledhja/matja e të dhënave hapsinore në terren dhe me saktësi në mënyrë që për prona të caktuara të ofrohet edhe saktësi e mjaftueshme për regjistrim në kadastër dhe në përputhje me udhëzimet e aprovuara nga AKK-ja.
8. Mbledhja/matja e të dhënave kadastrale në terren me saktësi në mënyrë që për objekte të caktuara të ofrohet edhe saktësi e mjaftueshme për regjistrim në kadastër dhe në përputhje me udhëzimet e aprovuara nga AKK-ja
9. Aerofotografimi i lokacioneve të caktuara dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis, perkatesisht vlerësimi i gjendjes për segmente të lumenjeve – e gjitha kjo me qëllim të përpilimit të raporteve për gjendjen aktuale të ndotjes së lumenjeve.

5. Realizimi i Projektit

Të gjitha të dhënat e dixhitalizuara duhet të dorëzohen në sistemin koordinativ shtetëror KosovaREF01 ashtu sic është përshkruar në pikën 5.1.

Projekti në fjalë duhet të realizohet sipas pikave të mëposhtme:

- Rilevimi i pikave me sistemin KOPOS të rrjeteve gjeodezike (trigonometrike dhe poligonale) dhe trajtimi i gabimeve eventuale,
- Llogaritja e të gjitha pikave detale (kufijve të parcelave) pas identifikimit të gabimeve,
- Analizimi i planeve kadastrale të gjeoreferencuara dhe rregullimi i parcelave
- Analizë e fletoreve takeometrike
- Rregullimi i parcelave sipas manualeve dhe skicave ekzistuese
- Transformimi i çdo dokumentacioni shtesë dhe trajnimi i stafit
- Rilevim me dron për krijimin e ortofotove për nevoja komunale
- Krijimi i raporteve të VMN-se dhe vleresimi i ndotjes së lumenjeve

5.1. Sistemi Koordinativ KosovaREF01

Kontraktori duhet të marrë parasysh se hartat dhe të dhënat e tjera hapsinore duhet të transformohet (në qoftë se ata nuk janë) në Sistemin Referent të Kosovës - KOSOVAREF01. Specifikimet e KOSOVAREF01, janë si më poshtë:

- Datumi Gjeodezik: ETRS89
- Elipsoidi Referent: GRS80,
- Projeksioni hartografik: Gauss-Kruger,
- Meridiani Fillestar: 21 E,
- Faktori i shkalles: 0.9999,
- Y fiktiv (False East): 7 500 000 m
- X fiktiv (False North): 0m

5.2. Rilevimi i pikave të rrjeteve gjeodezike (trigonometrike dhe poligonale) dhe trajtimi i gabimeve eventuale

Në mënyrë që të arrihet saktësi e matje gjatë realizimit të shërbimeve kadastrale dhe në mënyrë që aplikimi i teknologjisë GPS përkatesisht rrjetit permanent KOPOS të jetë në kuadër të normave kadastrale do të bëhet identifikimi në terren i pikave ekzistuese nga rrjetet trigonometrike klasike (trigonometrike

dhe poligonale). Këto pika pastaj do të rilevohen me GNSS në rrjetin gjeodezik permanent (KOPOS) dhe në dy seri ashtu siç definohet me udhëzimet administrative në fuqi. Këto koordinata të ri-fituara për pikat e rrjetit gjeodezik do të shfrytëzohen për kalkulimin e pikave detaje apo kufijve të parcelave nga fletoret takeometrike. Duke proceduar në këtë menyrë do të shmangen gabimet e ndodhura gjatë fazës së matjeve por edhe gabimet për shkak të barazimit të rrjetit në të kaluarën. Për secilen pikë të identifikuar në terren duhet të realizohet edhe një fotografi e gjendjes së saj. Këto fotografi i bashkangjiten raporteve dhe duhet të identifikohen me numër të pikës së rrjetit gjeodezik. Një detyrë e tillë nuk nënkupton zhvillimin e një rrjete të re, por vetëm hulumtimin dhe analizën e rrjeteve gjeodezike ekzistuese.

Formularët e rrjeteve gjeodezike ekzistuese përveç që do të shfrytëzohen për identifikim në terren të pikave gjeodezike (trigonometrike apo poligonale) të njejtin edhe do të arkivohen nëse mungojnë në arkivin e bërë nga AKK. Fillimisht të gjitha të dhënat ekzistuese në to do të barten në një tabelë apo formular dixhital (excel format). Pastaj formularët origjinal do të arkivohen në format PDF.

5.3. Llogaritja e të gjitha pikave detale (kufijve të parcelave) pas identifikimit të gabimeve eventuale

Të gjitha pikat detale të sistemuara në fletoret takeometrike do të kalkulohen dhe nga koordinata polare (kënd dhe gjatësi) do të transformohen në koordinata ortogonale Y dhe X (lindje, veri). Llogaritja e këtyre koordinatave do të realizohet duke u bazuar në pikat e rrjetit gjeodezik të transformuara dhe barazuara nga AKK e në rastë të caktuara, kur haset ndonjë gabim eventuale në transformim apo matjet në të kaluarën, kalkulimi i tyre do të bëhet nga pikat të cilat paraprakisht janë rilevuara me GNSS teknologji në dy seri sipas Kornizës të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale në fuqi. Numri i pikës përveç numrit rendor duhet të përmbajë edhe numrin e saj origjinal të specifikuar në fletore takeometrike apo skica detaje.

5.4. Analizimi i planeve kadastrale të gjeoreferencuara dhe rregullimi i parcelave

Planet kadastrale ekzistuese në ZKK të cilat janë të gjeoreferencuara nga ana e AKK-së, përkatësisht versionet më të fundit (më të update-uara) do të shërbejnë si bazë për analizimin e të dhënave vektoriale për njësitë kadastrale. Në rast se hasen gabime eventuale në kufirin e parcelave, atëherë të njëjtat do të korrigjohen sipas udhëzimeve nga Korniza 2020/01, pika 12.1. Format i kësaj shtrese duhet të jetë në CAD, ShapeFile apo ndonjë format tjetër zyrtar. Definimi i një parcele do të bëhet me pika të llogaritura paraprakisht nga fletoret takeometrike dhe vetëm në raste kur ato mungojnë mund të bëhet vektorizimi i pjesshem i planit kadastral. Nga këto plane poashtu do të merren numrat identifikues të njësive kadastrale.

5.5. Analizë e fletoreve takeometrike

Të gjitha fletoret takeometrike pasi të jenë shfrytëzuar për llogaritjen e pikave detale do të dhe arkivohen në folder të veçantë për secilën zonë kadastrale, në qoftë se të njëjtat nuk kanë qenë të skenuara paraprakisht nga AKK. Duhet të zhvillohet analizë e secilës fletore nëse është e lexueshme dhe mund të shfrytëzohet. Format i në të cilin do të arkivohen këto informacione duhet të jetë PDF ose ndonjë format tjetër.

5.6. Rregullimi i parcelave sipas manualeve dhe skicave ekzistuese

Nga skicat e formatit të madh dhe skicat detaje duhet bërë rregullimi i të dhënave vektoriale për parcelat. Kjo ndodh për arsye se gjatë mirëmbajtjes së rregullt të të dhënave kadastrale, një numër i madh të dhënave të ndarjeve të realizura në terren, nuk janë përcjellur në planet kadastrale në mirëmbajtje të përditshme.

Skicat dhe planet e tilla datojnë në periudhën e të viteve '90, por të njëjta mund të hasim edhe në periudhën e pas luftës.

Duhet të zhvillohet analizë e veçantë për skicat e mëdha dhe manualët ekzistuese në mënyrë që të identifikohen skicat të cilat nuk janë të skenuara nga AKK dhe të njëjtat skicat e formatit të madh dhe skicat detaje të cilat janë shfrytëzuar nga gjeodetët gjatë fazës së matjeve detaje në terren. Në keto skica manuale përveç numrave identifikues të parcelave figurojnë edhe të dhëna nga matjet origjinale siç janë numrat e pikave të kufirit të parcelave, gjatësi, kënde, data të rlevimit etj.

Zakonisht për një zonë kadastrale ekzistojnë numër i njëjtë i skicave me numrin e planeve kadastrale. Këto skica nëse nuk janë më herët të skenuara do të arkivohen në PDF format dhe të njëjtat do të shërbejnë për lidhjen e pikave kufitare të parcelave kadastrale.

Të njëjtat mund të shfrytëzohen gjatë procesit të lidhjes së pikave detaje dhe krijimit të parcelave. Këto manuale duhet të arkivohen në foldera të veçantë për secilën zonë kadastrale.

5.7. Transformimi i dokumentacionit tjetër dhe trajnimi i stafit

Çdo dokumentacion tjetër përveç atij të cekur më lartë dhe i cili nuk është i arkivuar në ZKK do të arkivohet. Forma dhe formati i arkivimit të dokumenteve të tjera do të përcaktohet gjatë fazës së ekzekutimit dhe në koordinim me ekspertet e ZKK-së. Duke synuar që komuna të arrijë trendet aktuale internacionale të zhvillimit dhe teknologjisë atehere synim i organeve komunale është edhe aplikimi i softëare-ve të reja konkretisht me synim në ato që janë OpenSource. I rekomanduar nga ana e eksperteve është edhe softëare QGIS andaj qëllim i këtij projekti është edhe instalimi i këtij moduli si dhe trajnimi dhe çertifikimi i stafit komunal për personimin dhe aplikimin e tij në shërbimet komunale. OE duhet të përgatisë një plan trajnimi në softuer, qoftë për stafin e ZKK-së po ashtu edhe për zyrtarët e tjerë komunal p.sh. Zyrtarët e urbanizimit apo dikasteret tjera që kanë të dhëna hapësinore. Këto të dhëna, mund të kërkohen nga OE që të dhënat e njëjta (Plane rregullative, urbane etj), të skenohen, të digjitalizohen dhe të gjeoreferencohen, dhe të njëjtat të dorëzohen në formatet adekuate pranë autoritetit kontraktues.

5.8. Rilevim me dron për krijimin e ortofotove për nevoja komunale

Rilevimi me dron luan një rol vendimtar në krijimin e ortofotografive të sakta dhe të përditësuara për nevojat komunale. Këto ortofoto përdoren për analiza të ndryshme, duke përfshirë monitorimin e ndryshimeve në ndërtime gjatë periudhave të ndryshme kohore, vlerësimin e shëndetit dhe rritjes së vreshtave dhe kryerjen e analizave të tjera gjeohapësinore sipas nevojave komunale për lokacione të caktuara.

Në disa raste, matjet me dron mund të kenë nevojë të përsëriten disa herë për të njëjtin vend për të siguruar mundësinë për analizë. Kjo qasje përsëritëse i ndihmon autoritetet komunale të marrin vendime të informuara bazuar në informacione të sakta dhe aktuale gjeohapësinore. Matje dron do të realizohen edhe për qëllime të vlerësimit të ndotjes së lumenjeve si dhe hartimi i raporteve të VMN-se nga hidroinxhinieri i certifikuar.

6. Të dhënat kadastrale

Kadastru shërben si bazë për regjistrimin e të drejtave pronësore me krijimin e njësive kadastrale për parcela, ndërtesa, pjesë të ndërtesave dhe përçojave dhe rindërtimin e informacioneve kadastrale. Të dhënat kadastrale dhe përmbajtja apo definimi i sistemit kadastral në Kosovë është rregulluar me ligjet në fuqi dhe pjesa më poshtë paraqet në formë të përgjithshme përshkrimin e disa elementeve të Kadastrit.

Kadastru përmban të dhëna grafike dhe tekstuale për parcelat e tokës, ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave, përçojave dhe objekteve nëntokësore në Kosovë.

➤ Baza tekstuale përmban:

- Numrin unik të secilës Zone Kadastrale brenda komunës.
- Të dhënat e pronarit (emrin, adresën, pjesa në përdorim të pronës ose në pronësi, hipoteka ose garanci tjera, vërejtje dhe korrigjime).
- Të dhënat e pronës (numrin e parcelës, planin, skicën, emrin e vendit, kulturën (llojin e përdorimit të tokës), klasën, zonën rurale / urbane, sipërfaqen, dhe datën e përditësimeve);

➤ Të Dhënat Grafike

- Të dhënat grafike janë në formë dixhitale/analoge dhe paraqiten në hartat kadastrale, skicat e terrenit, skica të detajuara, foto skica, ortofoto të gjeneruara nga droni për zonen urbane për parcelë të tokës dhe dokumentet e tjera të përcaktuara nga AKK-ja. Harta dixhitale kadastrale tregojnë kufijtë e njësive parcelave kadastrale, sistemin koordinat, referimet ndaj shenjave, simboleve, poligoneve përkufizuese, ndërtesa mbi një apo më shumë parcela, si dhe identifikuesit e parcelave dhe ndërtesave.

Përgjegjësia kryesore është të gjinden, inventarizohen dhe të paraqiten të gjitha pronat brenda juridiksionit, ligjeve, udhëzimeve dhe manualeve në fuqi. Një grup i plotë i të dhënave siç janë planet kadastrale, skicat, fletoret takeometrike, rrjeta gjeodezike, manualët si dhe të dhënat tekstuale janë të nevojshme për të arritur deri te finalizimi i të dhënave kadastrale. Planet, skicat, fletoret takeometrike si dhe manualët ndihmojnë në përcaktimin e vendndodhjes së pronës, tregojnë madhësinë dhe formën e secilës parcelë dhe përcaktojnë marrëdhëniet gjeografike që ndikojnë në vlerën e pronës. Hartat dhe të dhënat e hartave janë të rëndësishme jo vetëm për gjeodetët, por edhe për institucionet e tjera qeveritare dhe individët fizik. Kompjuterizimi i të dhënave të hartave dhe parcelave mund të përmirësojë aftësinë për të menaxhuar, analizuar, përmbledhur, shfaqur dhe shpërndarë informacionin e referuar gjeografikisht.

Plani gjeodezik është i saktë dhe përfaqësues besnik grafik i një pjese të vogël të tokës (natyrale apo artificiale) bashkë me format e tokës në rrafshin horizontal.

Plani i cili përfshin vetëm përfaqësim horizontal të tokës me ndihmën e shenjave përkatëse topografike, pa përfaqësim në lartësi të tokës (relievit) quhet plani kadastral, për shkak se ai përdoret kryesisht si i tillë në kadastrën tokësore.

Në vendin tonë planet gjeodezike janë përgatitur në shkallë 1:500, 1:1000, 1:2000, 1:2500 dhe 1:5000 në projeksionin e Gausit-Krygerit.

Planet kanë këtë përmbajtje thelbësore:

- Baza matematikore (rrjeta dhe pikat gjeodezike);
- Vijat kufitare të parcelave (bujqësore dhe të ndërtimit);
- Komunikimet (rrugët, hekurudhat, etj.) me vizatim të trupit së tokës dhe shpronësimin e brezit;
- Instalimet me objektet dhe pajisjet përcjellëse;
- Rrjeta hidrografike (lumenjtë, përrenjtë, pellgjet, liqenet, detet etj).;
- Shenjat topografi ke të vegjetacionit dhe kulturës së tokës;
- Të gjitha objektet të cilat për shkak të madhësisë së vogël nuk mund të përfaqësohen në shkallën e planit, por janë përfaqësuar nga shenjat e kushtëzuara topografike;
- Objektet ndërtimore (mbitokësore dhe nëntokësore);
- Emrat e vendbanimeve, viseve, objekteve dhe komunikimeve të ndryshme, pastaj emrat e objekteve hidrografike, format dhe lartësitë tokësore;
- Përshkrimi adekuat i planit.

Rrjeti gjeodezik paraqet tërësinë e pikave të vendosura e të ngulitura në terren, që kanë vendndodhje dhe lartësi të njohur (në rastin e rrjetit poligonal, lartësia është e panjohur) e të përcaktuar në një sistem të vetëm koordinatash në bazë të matjeve gjeodezike. Shërbejnë si pika mbështetëse gjatë rievimeve gjeodezike e topografike.

7. Të dhënat kadastrale digjitale – vështrim i përgjithshëm

Hartat kadastrale dixhitale, nëse shikohen në ekran ose si formë e shtypur, përfshijë elementët e mëposhtëm:

- Kufijtë e të gjitha parcelave
- Identifikuesit e parcelës

Bazuar në analizën që na e definojnë ose përcaktojnë të dhënat që na nevojiten, duhet të zgjidhet lloji i hartës kadastrale dixhitale. Në përgjithësi, ekzistojnë pesë lloje hartash dixhitale, duke filluar nga imazhet e skanuara të hartave të vjetra të përgatitura manualisht deri te hartat e krijuara përmes një modeli të të dhënave të parcelës.

Hartat ekzistuese si planet, skica nga terreni dhe manualet, thjesht mund të skanohen në një imazh raster. Të dhënat në formë rasterike janë relativisht të lira për t'u prodhuar, lehtë të qasëshme me anë të softurve të ndryshëm, po ashtu procesi i mirmbajtjes është tejet më i lehtë se i të dhënave në hard copy.

Harta të tilla të skanuara mund t'i referohen një rrjeti kontrollues gjeodezik, i cili mundëson gjeoreferencimin e planeve të skanuara. Këto plane të skanuara si atribut kryesor për parcelën kanë numrin e parcelës që zakonisht gjendet në mes të parcelës.

Rrjeti gjeodezik paraqet tërësinë e pikave të vendosura e të ngulitura në terren, që kanë vendndodhje dhe lartësi të njohur e të përcaktuara në një sistem të vetëm koordinatash në bazë të matjeve gjeodezike. Shërbejnë si pika mbështetëse gjatë rievimeve gjeodezike e topografike.

Rrjeti gjeodezik ekzistues duhet të verifikohet nëse ka gabime apo zhvendosje, sepse si rezultat i gabimeve shkaktohen më tutje gabime në llogaritjen e koordinatave të parcelave që do të dixhitalizohen. Që të realizohet faza e parë, por jo më pak e rëndësishmja, duhet të zhvillohen matje gjeodezike me njërin apo më shumë metoda gjeodezike për matje si GNSS, RTK ose matje klasike me stacion total. Matjet duhet të zhvillohen në seri dhe në periudha të ndryshme kohore dhe pastaj të bëhet barazimi i pikave të rrjetit gjeodezik. Duhet theksuar se duhet bërë analizë e rrjetit poligonal, në mënyrë që të bëhet identifikimi i gabimeve në të gjitha pikat e rrjetit poligonal dhe të vërtetohet nëse gabimi i bartur është i njëtrajtshëm në të gjitha pikat poligonale. Gjithashtu është e rëndësishme të ceket, se jo të gjitha pikat mund të gjenden në terren, sepse mund të jenë dëmtuar ose është ndërtuar diçka mbi to. Në rastet se gjatë analizës, konstatohet se gabimi është i njëtrajtshëm, atëherë në bazë të saj mund të bëhet llogaritja e pikave poligonale që mungojnë ose janë dëmtuar në terren.

Duhet të theksohet se planet, skicat si dhe rrjeti gjeodezik është krijuar në systemin koordinativ gjeodezik të atëhershëm(Fryref30).

Pikat rrjetit gjeodezik duhet ti nenshkrohen barazimit me softëare adekuat.

a) Llogaritja e koordinatave

Pas verifikimit të pikave të rrjetit gjeodezik me matje në terren dhe barazime të tjera, bëhet llogaritja e koordinatave duke përdorur formulat matematikore të cilat mundësojnë që nga fletoret takeometrike (që si bazë ofrojnë dy elemente shumë të rëndësishme: këndin e drejtimit dhe gjatësitë të brinjës në mes të dy pikave), planet dhe skicat e terrenit, mundësojnë që ta fitojmë pozicionin e saktë të secilës pikë të parcelës. Koordinatat e llogaritura nga elementet që u përmenden më lartë, janë në systemin koordinativ FRYREF30, i cili është përdorur në të kaluarën dhe koordinatat pastaj duhet të transformohen në sistemin koordinativ të Republikës së Kosovës, përkatësisht në Sistemin Koordinativ KOSOVAREF 01, i cili system përdoret në ditët e sotme që nga viti 2001 e tutje. Këto matje që dërgojnë deri të llogaritja e pikave në rastë kur ka gabime dhe evidentohen ato në proceset paraprake atëherë llogaritja bëhet duke u bazuar në manulin e matjeve. Trajtimi i gabimeve të transformimit të të dhënave Në rastet kur ka gabime në transformimin e pikave kufitare nga sistemi koordinativ Gauss Kryger në sistemin koordinativ Kosovaref01, atëherë gjeodeti duhet të gjejë në atë pjesë ku është duke e zhvilluar aktivitetin minimum dy pika të vjetra poligonale, të cilat janë shfrytëzuar/përdorur në procesin e matjes për parcelën apo bllokun e parcelave që trajtohen dhe i kanë koordinatat e njohura. Pastaj duhet të bëhet matja e këtyre pikave me GPS duke shfrytëzuar rrjetin KOPOS, dhe të bëhet krahasimi i koordinatave të matura me ato të fituara nga transformimi. Ndryshimi i cili fitohet duhet të korrigjohet në koordinatat e pikave të njësisë kadastrale.

Llogaritja e koordinatave është një element shumë i rëndësishëm dhe duhet të bëhet me kujdes të shtuar, sepse pastaj në bazë të tyre, vim deri te formimi i parcelave

The image shows two pages of a tachymetric record book. Each page is titled 'TAXIMETRISKI ZAPISNIK' and contains a grid of columns for recording survey data. The columns include station numbers, bearings, distances, and calculated coordinates. The data is handwritten in black ink.

Fig. 3. Shembull i një fletore takeometrike

Në tabelën në vazhdim, do të paraqesim parametrat e dy sistemeve koordinative:

Emri	FRYREF30	KOSOVAREF01
Viti i definimit	1924	2001
Periudha e përdorimit	1924-2001	2001-Ende
Datumi gjeodezik	Harmannskögel	ETRS89
Elipsoidi	Bessel 1841	GRS80
Projeksioni	Gauss–Krüger	Gauss–Krüger
Zona e projektimi	7	7
Gjeresia zonale	30	30
Meridiani fillestar	Grinuiçit	Grinuiçit
Meridiani qendror	21	21
Origjina e gjerësisë gjeografike:	Ekuatori	Ekuatori
Lindja fictive (false easting)	500000m	7500000m
Veriu fiktiv (False northing)	0m	0m
Faktori i shkallës	0.9999	0.9999
Njësia	Metër	Metër
Origjina e lartësive	Mareograph “Molo Sartorio” – Trieste, Italy	Mareograph “Molo Sartorio” – Trieste, Italy

Tabela 1. Parametrat e dy sistemeve koordinative të përdorur në Kosovë

b) Procesi i krijimit të parcelave në formë dixhitale

Pas analizës së rrjetës gjeodezike nëse ka gabime eventuale dhe llogaritjes së koordinatave të secilës parcelë veç e veç, si proces tjetër është përgatitje finale e parcelave në formatet standarte që përdoren në Republikën e Kosovës, përkatësisht si shapefile dhe formë vektoriale. Ekzistojnë njënumër i konsiderueshëm softuerësh që mund të përdoren për të realizuar këtë qëllim. Pjesë shumë e rëndësishme që i paraprin procesit të vektorizimit të secilës parcelë nga koordinatat e llogaritura është që parcelave t’u bëhet edhe identifikimi i numrave, që jo rrallë herë në plane mund të paraqiten probleme në identifikimin e saktë të tyre, për shkak se manualet, planet dhe skicat janë krijuar mekanikisht dhe kemi raste të ndryshme kur numri ose edhe ndonjë element tjetër është vështirë i dallueshëm.

Duhet të theksohet se duhet bërë edhe azhurnimi i ndarjeve/bashkimeve, të cilat në pjesën grafike nuk ekzistojnë, mirëpo këto ndarje/bashkime evidentohen në pjesën tekstuale. Me ndihmën e fletoreve dhe skicave të terrenit, duhet bërë identifikimi i këtyre rasteve. Këto raste duhet azhurnohen dhe paraqiten gjatë fazës së krijimit të parcelave dixhitale, pasi ndarjet e njëjta mund të mos ekzistojnë në planet e mëhershme.

Procesi i krijimit të parcelave dixhitale, në aspektin dixhital kalon në disa faza të tjera pas 2 fazave të mëparshme, përkatësisht korrigjimit të rrjetit gjeodezik dhe llogaritjes së koordinatave, si më poshtë:

8. Palët e interes

Ofrimi i të dhënave kadastrale do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Komuna e Rahovecit. Përmirësimi i shërbimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të “përkthehet” si përmirësim i jetës së qytetarëve. Ekziston një numër i madh i palëve të interesit të cilat tërthorazi apo direkt do të përfitojnë ngaky dixhitalizim. Grupimi më logjik i palëve të interesit do të ishte:

- Palët e interesit nga sektori publik dhe
- Palët e interesit nga sektori privat

9. Analiza e aseteve financiare që burojnë nga dixhitalizimi i të dhënave kadastrale

Duke pasur parasysh që ky projekt ka shumë benifite, Komuna e Rahovecit do të ketë rritje të të hyrave që lidhen direkt me pjesën e pronës. Pas përfundimit të projektit nëse marrim si shembull që komuna të inkasoj afro 10€ për produkte të parcelës (vektor) atëhere vlera e aseteve do të jetë mjet e konsiderueshme duke pasur parasysh numrin e madh të lëndëve që kryhen brenda një dite shtuar këtu, edhe pagesat për certifikatë të pronës dhe kopje të planit. Në tabelën numër 4 mund të shihni vlerën e aseteve për secilën zonë kadastrale duke i'u referuar shembullit më lartë.

Është edhe rasti tjetër nëse pagesa bëhet për koordinata (X,Y) të parces, le të marrim si vlerë minimale se secila parcelë ka vetëm 4 pika, atëherë vlera e aseteve për të gjitha zonat kadastrale do të jetë në disa miliona euro duke marr në konsideratë faktin e transaksione të shpeshta pronësore.

Vërejtje:

Trajnimi i stafit komunal dhe jo vetëm zyrtarëve kadastral por edhe zyrtarëve të tjerë që mirren me të dhënat hapësinore. Trajnimi duhet të bëhet me softuerin QGIS i cili është opensource. Qellim është edhe instalimi i ketij moduli si dhe trajnimi dhe çertifikimi i stafit komunal për përdorimin dhe aplikimin e tij në shërbimet komunale

DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT					
Nr.	Pershkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Çmimi per njesi	Totali
1. Rilevimi i pikave të rrjeteve gjeodezike dhe trajtimi i gabimeve eventuale, llogaritja e pikave detale të pikave nga matjet takeometrike dhe ortogonale si dhe analiza e fletoreve takeometrike dhe formulareve					
1.1	Rilevimi i pikave me sistemin KOPOS - Sistemi Kosovar i Pozicionimit të rrjeteve gjeodezike ekzistuese (trigonometrike dhe poligonale) dhe trajtimi i gabimeve eventuale	Pikë	1.00	0.01	0.01
1.2	Llogaritja e pikave detale (kufijve të parcelave) të pikave nga matjet takeometrike dhe ortogonale pas identifikimit të gabimeve, në çmim të përfshihet llogaritja për secilin pikë detaje	Pikë	1.00	1.44	1.44
1.3	Analiza e fletoreve takeometrike dhe formulareve të koordinatave ortogonale në qoftë se të njëjtat nuk kanë qenë të skenuara paraprakisht nga AKK (Agjencioni Kadastral i Kosovës). Duhet të zhvillohet analizë e secilës fletore nëse është e lexueshme dhe mund të shfrytëzohet	Fletë	1.00	0.01	0.01
NENTOTALI 1 (45%)					1.46
2. Analizimi i planeve kadastrale të gjeoreferencuara dhe rregullimi i parcelave sipas manualeve dhe skicave ekzistuese					
2.1	Analizimi i planeve kadastrale të gjeoreferencuara dhe rregullimi i parcelave	Pikë	1.00	0.01	0.01
2.2	Rregullimi i parcelave sipas manualeve dhe skicave ekzistuese	Parcelë	1.00	1.39	1.39
NENTOTALI 2 (30%)					1.40
3. Trajtimi i çdo dokumentacioni shtesë për nevoja komunale dhe rilevimet me dron					
3.1	Trajtimi i çdo dokumentacioni shtesë për nevoja komunale, të dhënat e njëjta (Plane rregullative, urbane etj), të skenohen, të digjitalizohen dhe të gjeoreferencohen, dhe të njëjtat të dorëzohen në formatet adekuate pranë autoritetit kontraktues (Forma dhe formati i arkivimit të dokumenteve të tjera do të përcaktohet gjatë fazës së ekzekutimit dhe në koordinim me ekspertet e ZKK-së)	Fletë	1.00	0.01	0.01
3.3	Rilevimi me dron për krijimin e ortofotove për nevoja komunale, për analiza të ndryshme hapësinore si dhe raporti i VMN-se - Vlersimi i ndikimi në mjedis në rast nevoje	m2	1.00	0.02	0.02



3.4	Krijimi i DEM - Modeli digjital I lartësive për zonat e rëlevuara me dron	Hektar	1.00	0.01	0.01
				NENTOTALI 3 (25%)	
				0.04	

REKAPITULLIMI			
	Peshimi (%)	Çmimi total i pa peshuar	Çmimi total i peshuar
1. Rilevimi i pikave të rrjeteve gjeodezike dhe trajtimi i gabimeve eventuale, llogaritja e pikave detale të pikave nga matjet takeometrike dhe ortogonale si dhe analiza e fletoreve takeometrike dhe formulareve	45%	1.46	0.66
2. Analizimi i planeve kadastrale të gjeoreferencuara dhe rregullimi i parcelave sipas manualeve dhe skicave ekzistuese	30%	1.40	0.42
3. Trajtimi i cdo dokumentacioni shtesë për nevojat komunale dhe rëlevimet me dron	25%	0.04	0.01
Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofertes dhe do të lexohet gjatë hapjes publike			1.09

